



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragaš/Dragash Municipality



Datë: 26.05.2026

Duke u bazuar në Nenin 68 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji nr. 03/L-040), Nenet 19, 22 dhe 28 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Nenin 57 të Statutit të Komunës së Dragashit Nr.06-103/, i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës shpall:

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

PLOTËSIM-NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Duke pas parasysh përmbushjen e kërkesave të qytetarëve dhe zbatimin e dispozitave ligjore, Komuna përdor mekanizmin e konsultimeve dhe pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në propozimet për aktet normative me interes të përgjithshëm për qytetarët.

Të gjithë qytetarët e interesuar, përfaqësues të institucioneve, shoqata të bizneseve, organizata joqeveritare, që me idetë dhe propozimet e tyre dëshirojnë të marrin pjesë në konsultimin publik lidhur me plotësim-ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave, mund ta bëjnë atë duke i shkarkuar të njëjtat nga uebfaqja zyrtare e Komunës së Dragashit në linkun:

<https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Rregullore-per-menaxhimin-e-mbeturinave-e-ndryshuar.docx>

Konsultimi publik elektronik dhe me shkrim mbetet i hapur nga data 26.05.2026 deri më 10.06.2026.

Diskutimi publik i drejtpërdrejtë me qytetarë do të mbahet më datë 10.06.2026, e Mërkurë, duke filluar nga ora 10:00, në sallën e Asamblesë Komunale.

Propozimet konkrete për këtë dokument mund t'i dërgoni në email adresat: redzep.ibraimi@rks-gov.net, fari.kolloni@rks-gov.net dhe dauti_67@live.com, deri në ditën e përmbylljes së këtij konsultimi publik, më 10.06.2026.

Inkurajohen të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në këtë Diskutim Publik!

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 352/12-10172/26
26.05.2026
Dragash - Dragaš



Kryetari i Komunës
Bexhet Xheladini